



## SYLLABUS I LËNDËS “E Drejta Familjare dhe Trashgimore”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Familjare dhe trashëgimore
Programi:	Juridik I pergjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6 Kredi
Koha / lokacioni:	Fakulteti Juridik
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Safet Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	<a href="mailto:safet.krasniqi@uni-prizren.com">safet.krasniqi@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>E Drejta Familjare si disiplinë shkencore dhe pjesë e të drejtës pozitive, përbën themelet dhe bazat e rregullimit juridik të marrëdhënieve familjare raportet ndërmjet bashkëshortëve në martesë dhe në bashkësi jashtëmartesore, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet tyre në marrëdhëniet pasurore, mbajtjen, ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur etj. Nga aspekti ligjor, rregullat dhe procedurat në të drejtën familjare janë të inkuorporuar në Ligjin për Familjet e Kosovës. Të gjitha këto janë procedura gjyqësore të cilat, domosdo duhet të përfundojnë me një vendim të plotfuqishëm i cili përmban të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve martesorë dhe jashtëmartesor që kanë të bëjnë me lidhjen e martesës, anulimin, shkurorëzimin apo edhe vërtetimin e ekzistimit të martesës. Po ashtu, ligji për familjen në përputhje me të drejtën familjare rregullon edhe raportet pasurore, adoptimin, vendosjen e fëmijëve në familje, marrjen e të drejtës prindërore, kthimin e kësaj të drejte etj.</p> <p>Institucionet juridike që janë objekti i studimit në të drejtën familjare, do të trajtohen duke u bazuar në të drejtën pozitive në Kosovë, duke përfshirë zhvillimet lidhur me projektin e hartimit të Kodit Civil, si dhe në të drejtën familjare krahasuese me sistemin Kontinental dhe Anglo-sakson. E Drejta Trashëgimore është studimi i</p>

	<p>marrëdhënieve që lindin në rastet e trashëgimit. Ndryshe kjo lëndë e drejta trashëgimore i rregullon marrëdhëniet e subjekteve në rastet e vdekjes, marrëdhëniet mortis causa.</p> <p>Sipas ligjit, trashëgimia është kalimi me Ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara me Ligj.</p> <p>Ky definicion ligjor i jep kuptim të drejtës trashëgimore si degë e së drejtës dhe si disiplinë shkencore.</p>		
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Fitimi i njohurive bazike nga studenti. Forma e shpjegimit të lëndës është e ndërlidhur me aspektin teorik dhe praktik. Kjo d.m.th. se përpos të drejtës në përgjithësi, studentët do të marrin njohuri edhe nga aspekti procedural (hartimi i padive dhe propozimeve përfshirë edhe procesverbalet për pranimin e atësisë, përpilimin e testeve etj.</p>		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Duke bashkuar interaktivitetin me anën praktike të lëndës, studenti ka mundësi të mësojë mjaftueshëm për lëndën. Njëkohësisht, ka mundësi që të arrijë të përvetësojë njohuri elementare dhe pas diplomimit të jetë në gjendje që të përfaqësojë në gjykatë ose para noterit palët lidhur me procedurat e shkurorëzimit me marrëveshje apo procedurën e trashëgimisë sipas propozimit të trashëgimtarëve.</p>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3+2	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	2	10	20
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	15	7.5
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	0.5	15	7.5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	5	35



Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)			5
Projektet, prezantimet ,etj			5
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>-Metoda e mësimdhënies aktive -Përkufizimi i parimeve dhe dispozitave të së drejtës penale , standardeve ndërkombëtare dhe Ligjit për Familjen , studentit i jep mundësi që të jetë i aftë në zbatimin e këtyre njohurive ne institucionet gjyqësore etj. në R.e Kosovës .</p> <p>- Metoda e mësimdhënies inter-aktive - Është metoda bashkëkohore e marrjes se dijes për lenden mësimore. Kjo realizohet përmes bisedave, ushtrimeve, punës grupore et, jatë tërë semestrit. Kjo metode është në frymën e proceseve te reja arsimore në Evrope. Në rrethana të reja, flitet jo vetëm për arsimimin por edhe për edukimin arsimor. Mësimdhënia dhe mësim nxënia janë dy koncepte te pandashme nga njëra-tjetra.</p> <p>- Metoda historike, është e rëndësishme për të shpjeguar gjenezën e parimeve dhe instituteve të së drejtës penale.</p> <p>- Metoda e studimit të rasteve - Ndihton në lehtësimin e të shpjeguarit dhe të kuptuarit të instituteve të së drejtës penale e që, në thelb ka praktikën gjyqësore . Kjo metode është bazë e mirë për të ardhmen e punës së studentëve të cilët percaktohen të punojnë në sistemin e drejtësisë. - Metoda krahasuese dhe metoda e analizës - Në botën globale, komunikimet akademike e shkencore janë thelbi i këmbimit dhe zgjerimin e njohurive gjatë dhe pas përfundimit të studimeve, duke pasur parasysh proceset globalizuese të jetës së përgjithshme shoqërore.</p> <p>Metodës sociologjike- E drejta Familjare dhe ajo trashëgimore nuk mund të kompletohen si shkence nëse nuk shpjegohen dhe analizohen fenomenet e ndryshme duke pasur parasysh jetën sociale të individëve dhe të grupimeve të ndryshme shoqërore.</p>		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<i>Nota</i>	<i>ECTS Nota</i>	<i>Piket</i>
	10	A	91-100%
			<i>Përkufizimi</i>
			SHKELQYESHEM-

				<i>njohuri të shkëlq. me pak gabime</i>
	9	B	81-90%	<i>SHUME MIRE- Në shumë[ se mesatarja ,por me disa gabime</i>
	8	C	71-80%	<i>MIRE, me disa gabime që vërehen qartë</i>
	7	D	61-70%	<i>KENAQSHEM- mire,por me mjaft gabime</i>
	6	E	51-60%	<i>MJAFTUESHEM- Kriteret minimale për kalueshmëri</i>
	5*	FX	40-50%	<i>DOBET— Përkushtim më i madh nga studenti për të kaluar</i>
	5	F	00-39%	<i>DOBET- kërkohet më tepër të arritur minimumin</i>
<b>Literatura</b>				
<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Abdulla Aliu &amp; Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007;</li> <li>- Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011;</li> </ul>			

	<p>- Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010;</p> <p>Aktet Normative:</p> <p>Ligji i Familjes i Kosovës, i hyrë në fuqi me datën .16.02.2006;</p> <p>Ligji nr. 06/L-077, plotësim ndryshimi i Ligjit për Familje nr. 2004/32;</p> <p>-Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, GZ e KSAK nr,10/84, date 28 mars 1984;</p> <p>-Ligji për Trashëgimi i Kosovës, i hyrë në fuqi me dt. 4 shkurt 2005;</p> <p>- Ligji nr. 06/008, plotësim ndryshimi i Ligjit për Trashëgimi i Republikës së Kosovmës, nr. 2004/26;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Deklarata e përgjithshme e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1948,</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, 1950;</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa OKB-së, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1979</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa e OKB-së, për të drejtat e fëmijëve, 1990</li> <li><input type="checkbox"/> Deklarata e përgjithshme e OKB-së për të drejtat e njeriut, 1948,</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, 1950</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa OKB-së, per eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, 1979</li> <li><input type="checkbox"/> Konventa e OKB-së, për të drejtat e fëmijëve, 1990</li> </ul>
<p><b>Literatura shtesë:</b></p>	<p>-Dr. Juliana Latifi, E drejta e trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë 2010;</p> <p>-Andria Gams, Hyrje në të drejtën civile, Pjesa për të drejtën e trashëgimit, Prishtinë 1986</p> <p>-Francesko Galgano, E drejta private, Luarasi, 2003;</p>

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni dhe emërtimi i të drejtës familjare, objekti i të drejtës familjare;</li> <li>- Metodatat e studimit të së drejtës familjare,</li> <li>- Parimet themelore të së drejtës familjare</li> <li>- Burimet e së drejtës familjare</li> <li>- Marrëdhëniet e së drejtës familjare me disiplinat tjera shkencore.</li> </ul>	
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni i familjes</li> <li>- Llojet e familjes</li> <li>- Funksionet e familjes</li> <li>- - Struktura e lidhjeve familjare (gjinia e gjakut, gjinia e krushqisë, gjinia e adoptimit)</li> </ul>	
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hyrje në të drejtën martesore dhe kuptimi i saj</li> <li>- Objekti i të drejtës martesore</li> <li>- Subjektet t të drejtës martesore</li> <li>- Parimet themelore të të drejtës martesore</li> <li>- Fejesa</li> <li>- Martesa dhe kuptimi i saj</li> <li>- Qëllimet martesore</li> <li>- Kushtet për lidhjen e martesës</li> <li>- Pengesat martesore</li> <li>- Ndalesat martesore</li> <li>- Kushtet formale për lidhjen e martesës</li> <li>- Procedura paraprake</li> <li>- Lidhja e martesës</li> </ul>	

<p><i>Java e katërt:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve - Zgjidhja e martesës, mënyrat, shkaqet dhe procedura e shkurorezimit</li> <li>- Pasojat juridike të zgjidhjes së martesës</li> <li>- Bashkësia jashtëmartesore si dukuri shoqërore</li> <li>- Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore</li> </ul>	
<p><i>Java e pestë:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve</li> <li>- Subjektet e të drejtës prindërore - legjitimimi i fëmijëve, statusi i fëmijëve martesor, statusi i fëmijëve jashtëmartesor</li> <li>- Kundërshtimi i amësisë dhe kundërshtimi i atësisë</li> <li>- Procedurat e kundërshtimi të amësisë dhe atësisë</li> <li>- Njohja e amësisë dhe e atësisë</li> <li>- Vërtetimi i amësisë dhe atësisë me vendim të gjykatës</li> <li>- E drejta prindërore (kuptimi dhe objekti)</li> <li>- Marrëdhëniet personale dhe pasurore mes prindërve dhe fëmijëve</li> <li>- Ushtrimi i të drejtës prindërore</li> <li>Pezullimi, kufizimi, heqja dhe vazhdimi dhe mbarimi i të drejtës prindërore</li> </ul>	
<p><i>Java e gjashtë:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Adoptimi / birësimi</li> </ul>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Procedurat e themelimit të adoptimit, efektet juridike të adoptimit</li> <li>- Endosja e organizuar e fëmijës në familjen tjetër për përkujdesje</li> <li>- Detyrimet e ushqimit (mbajtja financiar)</li> <li>- Personat e detyruar për dhënien e ushqimit</li> </ul> <p>Kushtet për dhënien e ushqimi</p>	
<i>Java e shtatë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet pasurore - regjimi i kontraktimit</li> <li>- E drejta e kujdestarisë - personat nënë kujdestari</li> <li>- Kujdestaria ndaj fëmijëve të mitur</li> <li>- Kujdestaria ndaj personave me pazotësi të veprimit (zotësi të hequr të veprimit)</li> <li>- Rastet e veçanta të kujdestarisë</li> <li>- Rastet e veçanta të kujdestarisë kur nuk janë përcaktuar me dispozita ligjore</li> <li>- Pushimi i kujdestarisë</li> </ul>	
<i>Java e tetë:</i>	Vlersimi i parë	
<i>Java e nëntë:</i>	<p>II. E DREJTA TRASHËGIMORE</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni dhe emërtimi i të drejtës trashëgimore</li> <li>- Objekti i të drejtës trashëgimore</li> <li>- Parimet themelore të së drejtës trashëgimore</li> </ul> <p>Burimet e të drejtës trashëgimore dhe metodat</p>	



<i>Java e dhjetë:</i>	Trashëgimi me ligj - koha dhe vend i çeljes (hapjes) së trashëgimit, trashëgimlënësi, trashëgimtari, -Aftësia për të trashëguar	
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bazat e thirrjes në trashëgim</li> <li>- Sistemet për caktimin e radhëve për thirrje në trashëgimi ligjore</li> </ul> Radhët e trashëgimisë, e drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit	
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trashëgimia e domosdoshme, padenjësia për trashëgim,</li> <li>- Pranimi i trashëgimit</li> <li>- Renoncimi (heqja dorë) nga trashëgimi</li> <li>- Ndarja e trashëgimisë</li> </ul> Transaksionet ndërmjet të gjallëve (inter vivos)	
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trashëgimia testamentare</li> <li>- Forma, kuptimi dhe përmbajtja e testamentit</li> </ul> Zotësia për të bërë testament	
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pavlefshmëria e testamentit</li> <li>- Legu</li> </ul> Llojet e testamentit	
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë	

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

-Studentët duhet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata dhe ushtrime, me ç ‘rast pjesëmarrja dëshmohet me listën e frekuentimit përmes nënshkrimeve të vetë studentëve;

- Pjesëmarrja e rregullt në leksione dhe ushtrime, prezantimi i punimeve seminarike dhe aktivitete të tjera do të llogariten në vlerësimin përfundimtar;

- Në ligjërata dhe ushtrime, duhet të trajtohen vetëm temat e parashikuara në këtë plan program;

-Komunikimi me studentët do të bëhet drejtpërdrejtë në ligjërata dhe ushtrime, përmes postave elektronike dhe postimeve në web-faqen e Universitetit.

